



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**  
**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office of the**  
**Chief State Prosecutor**

A.nr. 170 / 2025  
Datë: 02.04.2025  
Prishtinë

Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nv.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, në zbatim të nenit 276 të Kodit të Procedurës Penale Nr.08/L-32 (KPP) për pasurinë që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, të ndërlidhur me veprat penale nga Kapitulli XXIII [Veprat Penale të Narkotikëve], me saktësisht nenet 267 – 272 të Kodit Penalë të Republikës së Kosovës, me qëllim të unifikimit të praktikave të punës në prokuroritë themelore dhe Prokurorinë Speciale nxjerr këtë:

**UDHËZIM**

**PËR PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT ME RASTIN E KONFISKIMIT TË**  
**SENDEVE QË JANË QENËSISHT TË RREZIKSHME OSE PALIGJSHME QË I**  
**NËNSHTROHET KONFISKIMIT AUTOMATIKISHT**

1. Menjëherë pas sekuestrimit / konfiskimit të lëndëve narkotike, Prokurori duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar sasinë, llojin dhe detajet tjera përkatëse të substancave dhe duhet të urdhërojë që të merren prova fotografike për të mbështetur procesin e sekuestrimit / konfiskimit/shkatërrimit të lëndës narkotike.
2. Menjëherë pas konfiskimit, Agjencia e Forenzikës duhet të kryejë analizën për të konfirmuar llojin/natyrën dhe përbërjen e substancave të sekuestruara. Rezultatet e analizës duhet të përshkruhen në një raport të detajuar.
3. Pas analizimit dhe verifikimit nga ana e Agjencisë së Forenzikës, në rastet kur konstatohet se sasia e konfiskuar përbën lëndë narkotike, së paku tri (3) mostra të ekstraktuara nga lëndët narkotike duhet të ruhen dhe të cilat do të shërbejnë si provë në gjykatë.
4. Çdo mostër duhet të etiketohet saktësisht, të mbyllet dhe të ruhet në Dhomën e Dëshmive të Policisë së Kosovës për të garantuar integritetin / autenticitetin e saj. Mostrat e etiketuara evidentohen në Regjistrin elektronik të Policisë dhe në SMIL.
5. Nëse lënda narkotike e konfiskuar përbehet nga lloje dhe paketime të ndryshme të substancave narkotike, në këto raste duhet të ruhen së paku nga tri (3) mostra për secilin lloj dhe paketim të lëndës / substancës narkotike.

6. Pas analizës forenzike dhe ruajtjes së mostrave, prokurori përgjegjës duhet të kërkojë nga Gjykata urdhrin për shkatërrim për të autorizuar shkatërrimin e pjesës së mbetur të lëndëve narkotike.

7. Pas marrjes së urdhrin për shkatërrim, lëndët narkotike duhet të shkatërrohen menjëherë sipas procedurave të përcaktuara që sigurojnë asgjësim të plotë dhe të pakthyeshëm. Procesi i shkatërrimit duhet të përshkruhet në një raport që përfshin metodën e shkatërrimit, datën, vendndodhjen dhe zyrtarët e përfshirë.

8. Procesi i shkatërrimit të lëndëve narkotike zhvillohet në prani të një Komisioni mbikëqyrës, i cili garanton që procesi të jetë i ligjshëm, transparent dhe i dokumentuar në mënyrë të rregullt. Komisioni duhet të përbëhet nga përfaqësues të këtyre institucioneve:

- Prokuroria (prokurori i rastit aspo përfaqësuesi i tij i autorizuar);
- Policia e Kosovës (përfaqësues nga njësia hetimore përkatëse dhe përfaqësues nga Dhoma e Dëshmimeve);
- Agjencia e Forenzikës;
- Përfaqësues i Gjykatës (nëse është e aplikueshme dhe e mundur në praktikë);
- Përfaqësuesi i të pandehurit - mbrojtja (nëse është e aplikueshme dhe i ftuar në përputhje me rrethanat e rastit);
- Përfaqësues të institucioneve të tjera ligj zbatuese (p.sh.: Doganat) ose institucioneve tjera, sipas rastit dhe nëse është e nevojshme.

Përfaqësuesi i Policisë nga Dhoma e Dëshmimeve përgatit procesverbalin zyrtar për shkatërrimin, në të cilin përshkruhet detajisht mënyra e shkatërrimit, vendi, koha, sasia e substancës së shkatërruar dhe të gjithë zyrtarët pjesëmarrës. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe bëhet pjesë e dosjes së lëndës.

9. I gjithë dokumentacioni në lidhje me sekuestrimin/konfiskimin, analizën, ruajtjen e mostrave, kërkesën për shkatërrim, urdhrin gjyqësor për shkatërrim dhe shkatërrimin e lëndëve narkotike duhet të mbahet në dosjen e lëndës. Këto dokumente/dëshmi duhet të jenë të gatshme për shqyrtim gjatë procedurave gjyqësore.

10. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Besim Kelmendi  
UD Kryeprokuror i Shtetit



Udhëzimi i dërgohet:

- Të gjithë Kryeprokurorëve dhe prokurorëve të shtetit
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.